



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:170669

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740783

**C.nr.2823/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.S. me numër personal .... nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 304.32 euro, jashtë seance, me datë 27.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.S. nga Prizreni. **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësi të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.08.2019 – 31.12. 2019, në shumën prej 32.53 euro;
2. Për periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020, në shumën prej 5.74 euro;
3. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 98.32 euro;
4. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 30.06.2022, në shumën prej 167.73 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 304.32 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

## A r s y e t i m

Paditësi M.S. nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 22.08.2022, përmes të autorizuarit të tij A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditësi është punëtor i arsimit pranë SHML “Gjon Buzuku” në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Me parashtresën e datës 05.04.2024, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e padisë, duke theksuar se paditësi ka pagën bazë në shumën prej 241.00 euro dhe i takon e drejta në kompensim sipas inflacionit nga data 01.08.2019 deri me datën 30.06.2022, në shumë të përgjithshme prej 304.32 euro dhe atë, për vitin 2019 -  $241 \times 2.7\% = 6.50$  euro për muaj  $\times 5 = 32.53$  euro, për vitin 2020 -  $241 \times 0.2\% = 0.48$  euro për muaj  $\times 12$  muaj = 5.74 euro, për vitin 2021 -  $241 \times 3.4\% = 8.19$  euro për muaj  $\times 12$  muaj = 98.32 euro dhe për vitin 2022 –  $241 \times 11.6\% = 27.95$  euro për muaj  $\times 6$  muaj = 167.73 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 10.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendon paditësja nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit, nr.01B/ të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës

22.01.2021 padia dhe kërkesëpafia e paditësit është e pabazuar. Po ashtu, ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitin 2019 dhe deri më 22.08.2022 është parashkruar, sipas nenit 353 të LMD-së, pasi që kanë kaluar mbi 3 vite. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpafia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës nr. protokollit 1402 e datës 22.09.2021, kontrata nr. protokollit 533 e datës 22.09.2020, kontrata nr. protokollit 729 e datës 11.09.2019 dhe kontrata nr. protokollit 330 e datës 12.09.2019 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit dhe nga vërtetimi me nr. protokollit 35/50 të datës 15.11.2023 të lëshuar nga Gjimnazi “Gjon Buzuku” në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek Gjimnazi “Gjon Buzuku” në Prizren, si punëtor ndihmës-technik, që nga data 26.06.1999 dhe vazhdon të jetë edhe më tutje. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 241.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë :

- Për periudhën 01.08.2019 - 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 241.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 32.53 euro ( $241 * 2.7\% = 6.50 * 5 = 32.53$ )
- Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 241.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.74 euro ( $241 * 0.2\% = 0.48 * 12 = 5.74$ )
- Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 241.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.32 euro ( $241 * 3.4\% = 8.19 * 12 = 98.32$ )
- Për periudhën 01.01.2022-30.06.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 241.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 167.73 euro ( $241 * 11.6\% = 27.95 * 6 = 167.73$ ). Apo në shumë të përgjithshme prej 304.32 euro duke e llogaritur për periudhën 01 Gusht 2019 deri 30 Qershor 2022 ( $32.53 + 5.74 + 98.32 + 167.73 = 304.32$ ).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 152 të LPK-së ku parashihet që “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar e gjeti të pa bazuar, pasi që me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 19.08.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.08.2019 e deri më 30.06.2022, gjykata konstaton se parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin Gusht 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e Gusht 2019, e cila pagë realizohet në fund të muajit rrjedhimisht e njëjta atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për

kompensimin e kualifikimit për muajin Gusht 2019 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Shtator 2019, e njëjta ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, ku parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”* rrjedhimisht këtu paditësja nga fillimi i Shtator 2019 ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit nga këtu e paditura, e që nënkupton se padia e paditëses për periudhën 01.08.2019 e deri më 30.06.2022, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të LP-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara dhe atë lidhur me precizimin e padisë në vlerës prej 104 euro, pasi që gjykata ka njohur shpenzimet për përpilimin e padisë e cila me paraqitjen e në gjykatës duhet të jetë e caktuar dhe e precizuar.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:170669, 27.05.2024

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën